**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-19-4303-5-2-1/C188**
**14 Nr. 811/19**
**Dt. 26.08.2019**

# KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj - Drejtoreshë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PUNËDHËNËSI)** , dhe

2. **" Rexha "sh.p.k. Emri i biznesit,** me seli në **Ferizaj**, me **NrUI : 810515223 dhe " Eko Group "sh.p.k. Emri i biznesit, me seli në Prishtinë, me NrUI : 810872582**, të cilët i përfaqëson **z. Samir Rexha**, në tekstin e mëtejmë: **PUNËMARRËSI,**

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

**Ndërtimi i Sheshit " Ahmet Krasniqi "** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 9 | 43 | 3 | 0 | 5 | 2 | 1 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 9 | 0 | 6 | 9 | 5 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Ndërtimi i Sheshit " Ahmet Krasniqi "në qytetin e Vushtrrisë,** sipas projektit, dokumentacionit standard, Projektit dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-069-521.**

1.2 **Afati i fillimit të punimeve është 3 ( tri ) dite** pas nënshkrimit të kontratës, pasi të jetë bërë kërkesa nga Menaxheri i Kontratës i Punëdhënësit për fillim të punimeve dhe në rast se kushtet klimatike, nga palët nënshkruese të kësaj Kontrate, vlerësohen të përshtatshme për punë.

1.3 **Punëdhënësi obligohet që para fillimit të punimeve t'ia dorëzoi Punëmarrësit tërë dokumentacionin e kompletuar të projektit në fjalë.**

1.4 Projekti do të realizohet brenda periudhës dy vjeçare, sipas afatit të përcaktuar nga Palët kontraktuese, por jo më gjatë se **data: 31.09.2020.**

1.5 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Projektit si dhe Organin Mbikëqyrës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e projektit.

1.6 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin.

1.7 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto çështje.

1.8 Punëmarrësi ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.9 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej **0,10%** të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustifikuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

1.10 Punëmarrësi, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik të punimeve, përmes afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se **36 muaj**, e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të LMD-së që rregullojnë këtë çështje.

1.11 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.

1.12 Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.

1.13 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh pune nga dita e dërgimit të ftesës.

1.14 Në rast se Punëmarrësi në afatin e paraparë nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit, duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.

1.15 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit jo adekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LDM-së që rregullojnë këtë çështje.

1.16 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do ti vërtetoi punimet e kryera sipas dinamikës, konformë specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

**Pranimi teknik i objektit**

1.17 Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkoi pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatoi procedurat e pranimit teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Organi Mbikëqyrës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin mbi përfundimin e gjitha punëve të parapara.

1.18 Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitoi Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për një periudhë garantuese të defekteve prej 13 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtje së parasë

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë në euro dhe kapë shumën prej: **93.664,17€ ( nëntdhjetetremijgjashqindgjashtdhjetekatër/17Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : **në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.**

2.4 **Shuma e pagesës në avans nuk aplikohet.**

**2.5 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit si dhe duke qenë se projekti në fjalë është projekt afatgjatë ( dy vjeçar ), ndërkaq prokurimi për realizimin e projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit që duhen përmbushur nga përvetësimet në vitin fiskal 2019 dhe 2020, palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare në këtë vit, 2019, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me nr. prok. 644 – 19 – 069 – 521, respektivisht dinamika e realizimit të projektit të realizohet, me sa vijon :**

- **Në vitin kalendarik 2019, deri në shumën prej: 40.000,00€, ndërsa**

- **Në vitin kalendarik 2020, sipas planifikimeve buxhetore dhe përvetësimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit që duhen planifikuar dhe përvetësuar për vitin në fjalë, respektivisht në shumë prej : 53.664,17€.**

2.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(f) Plani për menaxhimin e kontratës;

(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

3.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do ti marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me **nr. prok. 644 – 19 – 069 - 521.**

3.4. Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë ( Departamenti për Çështje Ekonomike ), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me nr. prok. 644 – 17 – 169 - 511.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në katër origjinale, prej të cilave 3 janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Saranda Cakaj |
| **Pozita:** | Drejtoreshë e Drejtorisë për prokurim publik |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 26.08.2019 |
| **Vula:** | |

**Për Kontraktuesin:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Samir Rexha |
| **Pozita:** | Përfaqësues i Kryesit të Punëve:<br>“ Rexha “sh.p.k. & “ Eko Group “ sh.p.k. – Prishtinë |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 26.08.2019 |
| **Vula:** | |

[1] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

| *Nr.* | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi për njësi pa TVSH* | *Norma e TVSH-së në %* | *Çmimi për njësi (me TVSh)-€* | *Totali (Pa TVSH)* | *TVSH* | *Totali (me TVSH)-€* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1 | Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhët të përfshijë: Blerjën, furnizimin,transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.Të gjitha demet e shkaktuara gjatë ekzekutimit në infrastrukturë nënë dhe mbitoksore janë barra e vetë punkryesit | | | | | | | | |
| ***A*** | ***PUNËT E PËRGADITJES SË PUNISHTES*** | | | | | | | | |
| 1 | Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt | paushall | 1.00 | 0.85 | **18.00** | **1.00** | 0.85 | 0.15 | **1.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Kontrollimi dhe evdentimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi I planit detal operativ që lidhet më procesit të ndërtimit | m² | 2,739.00 | 0.76 | **18.00** | **0.90** | 2,089.07 | 376.03 | **2,465.10** |
| 3 | Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperve te rrjetes shtetrore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do te kaloj rrjeti hidroteknik: ujsjellësi, kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik. | m² | 2,739.00 | 0.76 | **18.00** | **0.90** | 2,089.07 | 376.03 | **2,465.10** |
| 4 | Egzaminimi i materialeve dhe bazes se rrugës para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. gurit dhe elmenteve tjera per shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përardhjen e materialit para fillimit të punimeve. | p.s. | 1.00 | 127.12 | **18.00** | **150.00** | 127.12 | 22.88 | **150.00** |
| 5 | Punimi I projektit kryesor zbatues - ARHIVES pas evidentimit final te instalimeve ekzistuese,ndryshimeve eventuale dhe bartja e tyre ne nje projekt final I mbetur ne arhiven e invetitorit.Punimi duhet te perfundohet ne kordinimin me projektantet dhe mbikqyresit e punishtes. Llogaritja behet ne baze te vleres investuese. | p.s. | 1.00 | 381.36 | **18.00** | **450.00** | 381.36 | 68.64 | **450.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TOTALI A : | | | | | | 4,687.46 | 843.74 | 5,531.20 |
| | | | | | | | | | |
| **B** | ***DEMOLIMI I INSTALIMEVE NË SHESH*** | | | | | | | | |
| 1 | Gërryerja e shtresës ekzistuese te asfaltit në pjesën e vjetër edhe atë sipas udhëzimeve nga projekti dhe të organit mbikqyrës te punishtës. Trashësia e gërryerjes duhet të jetë t=10 cm. Materiali i grumbulluar duhet të largohet në një vend të caktuar sipas udhëzimeve te organit mbikqyrës. | $m^2$ | 2,234.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 3,786.44 | 681.56 | **4,468.00** |
| 2 | Demolimi i shtresës së tamponit dhe shtresës së poshtme egzistuese ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës. Pjesa për demolim duhet të parashihet në pjesën ku planifikohet zgjerimi i rrugës edhe atë sipas të dhënave në projekt. | $m^3$ | 145.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 245.76 | 44.24 | **290.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Demolimi i kubzave të gurit dhe gurve skajorë dhe betoneve në pjesën e trotuareve, ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton organi mbikqyrës. | $m^2$ | 216.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 366.10 | 65.90 | **432.00** |
| 4 | Demolimi i kubzave të betonit në pjesën e trotuareve në afërsi të objektit ( hamami ) ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton organi mbikqyrës. | $m^2$ | 165.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 279.66 | 50.34 | **330.00** |
| 5 | Demolimi i rrethojave metalike të vendosura në shirit betoni me lartësi prej 0-1.0m në të dy anët e rrugës në vendet , ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në vendin te cilin e cakton organi mbikqyrës. | m' | 185.00 | 1.27 | **18.00** | **1.50** | 235.17 | 42.33 | **277.50** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Demolimi dhe bartja e kubzave te granitit ( KALLDRMES SE VJETER) në pjesën trotuarit me sasi te ndryshueshme. Materiali duhet të njihet në copë në prezencë të investitorit ose një komisioni te veqantë dhe të bartet në një lokacion ku e cakton organi kompetent Komunal.Materiali i njëjtë duhet te rikthehet në trotuarin egzistues edhe atë te punuar ne sipërfaqe sipas urdhrave të org. mbikqyrës | paushall | 1.00 | 211.86 | **18.00** | **250.00** | 211.86 | 38.14 | **250.00** |
| **TOTALI B :** | | | | | | | **5,125.00** | **922.50** | **6,047.50** |
| | | | | | | | | | |
| **C** | ***PUNËT NDËRTIMORE*** | | | | | | | | |
| 1 | Gërmi I dheut ne hapsiren ku do të vendosjet shtatorja ne thellesi h=1.20m | $m^3$ | 10.50 | 2.12 | **18.00** | **2.50** | 22.25 | 4.00 | **26.25** |
| 2 | Furnizimi me materjal zhavor 0-64mm me trashësi t=20cm ne fundin e theemlit I planifikuar dhe ngjeshurë | $m^3$ | 1.50 | 9.32 | **18.00** | **11.00** | 13.98 | 2.52 | **16.50** |
| 3 | Furnizim , latimi dhe armimi I themeleve dhe pllatos së shtatorës | kg | 1,160.00 | 0.57 | **18.00** | **0.67** | 658.64 | 118.56 | **777.20** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Furnizimi me materjal , latimi dhe betoni I bazamenteit të pllatos me Mb 25/30 me natyr beton i kualitetit të larte . | $m^3$ | 23.75 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 1,408.90 | 253.60 | **1,662.50** |
| 5 | Furnizimi transporti dhe montimi I gurit monolit (magmatik thellsionorë )me dimensione 1,2x1,2x1,70m', guri duhet të jetë nga të katër anët sipërfaqe të drejtë të gdhendura , Vreejtëje në sipërfaqen ku do të ankerohet shtatorje duehet të jetë sipërfaqe e lëmuarë | copë | 1.00 | 508.47 | **18.00** | **600.00** | 508.47 | 91.53 | **600.00** |
| 6 | Gërmimi I kanlit me dimensione 0,25x0,40x170, materjli I gërmuarë të ngarkohet dhe transponë vendin e caktuar | m' | 170.00 | 1.27 | **18.00** | **1.50** | 216.10 | 38.90 | **255.00** |
| 7 | Furnizimi me materjal , latimi dhe betoni dhe armimi I bazamenteit të kanli dhe mureve me Mb 25/30 me beton i kualitetit të larte .me dimensione 0,10x0,10x170 mbi pllaken me trashësi t=15cm | $m^3$ | 25.50 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 1,512.71 | 272.29 | **1,785.00** |
| 8 | Furnizimi dhe montimi I ujëmbledhsit nga materjali llamarinë e plastifikuar me trashësi t=0,7mm me dimensione 15x1,5x15xme gjëri të zhvilluarë b=90cm formen sipas projektit | m' | 170.00 | 15.25 | **18.00** | **18.00** | 2,593.22 | 466.78 | **3,060.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Furnizimi me materjal dhe montimi I ujmbledhsve me diemnsione me diametër d=30cm I punuarë sipas normave teknike per këtë llojë pune me ujmbledhës të zinguarë dimensione 15x15x4cm në këtë pozcionë është përfshirë kyqja në kanlizimin atmosferik në rrjte ne distancë L=10m' | copë | 5.00 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 254.24 | 45.76 | **300.00** |
| 10 | Planifikimi dhe nivelizimi i nënbazes në pjesën e zgjerimit te rrugës dhe në pjesën ecila do të trajtohet sipas profileve në projekt si dhe ngjeshja e saj me cilinder deri në masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për ketë lloj pune (Mt≥400 kg/cm²) | m² | 2,234.00 | 0.51 | **18.00** | **0.60** | 1,135.93 | 204.47 | **1,340.40** |
| 11 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës se gjeotekstilit në pjesën e rrugës e cila do te ndertohet vetem asfalt. Gjeosintetika duhet te jetë 315 g/m² dhe duhet ti përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj materiali. | m² | 2,234.00 | 0.68 | **18.00** | **0.80** | 1,514.58 | 272.62 | **1,787.20** |
| 12 | Furnizimi,transporti dhe shtrirja e rerës për mbrojtjen e gjeotekstilit me trashësi min 5 cm duke paraparë edhe nivelizimin për shtresat në vazhdim sipas profilit tërthor. | m³ | 111.70 | 9.32 | **18.00** | **11.00** | 1,041.27 | 187.43 | **1,228.70** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 32-64 mm me trashësi të shtresës d=30cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt≥800 kg/cm²). | $m^3$ | 67.50 | 6.78 | **18.00** | **8.00** | 457.63 | 82.37 | **540.00** |
| 14 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-31,5 mm me trashësi të shtresës d=20cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt≥1000 kg/cm²). | $m^3$ | 446.80 | 6.78 | **18.00** | **8.00** | 3,029.15 | 545.25 | **3,574.40** |
| 15 | Furnizimi,transporti dhe shtrirja e shtreses nivelizuese FILER prej rerës për nivelizimin e siperfaqes per pegaditjen e pllakes se betonit me trashësi 5-7cm duke paraparë edhe nivelizimin për shtresat në vazhdim sipas profilit tërthor. | $m^3$ | 156.38 | 9.32 | **18.00** | **11.00** | 1,457.78 | 262.40 | **1,720.18** |
| 16 | Furnizimi me gyp nga materiali PVC , per vendosjen ne kanalin e drenimit. Gypi duhet te jete i tipit te veqant per drenazh dhe me dimension D=200 mm. | m' | 156.00 | 2.54 | **18.00** | **3.00** | 396.61 | 71.39 | **468.00** |
| | **TOTALI C:** | | | | | | **16,221.47** | **2,919.86** | **19,141.33** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **D** | ***PUNËT E MVESHJEVE FINALE*** | | | | | | | | |
| 1 | Furnizimi , transporti dhe vendosja e pllakave te bëtonit nga guret natyral (Granit,Kuarcit,Diabazit)etj. te Llojit TERASTONE PLLAKA TIP 2/234 S ranore me dimenzione 30x20x12cm Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2:2004 Pllaka per perdorim ne hapsira te hapura ne ambiente te jashtme. Montimi i materialit duhet ti permbahet udhezimeve teknike per kete lloj materiali dhe gjithmon sipas udhezimeve te Projektantit, prodhuesit si dhe organit mbikqyres. Materiali i granitit nga guret natyral karakterizohet me keto pika te veqanta:të tëstuar në 25 cikluse... Vërejtje: Materiali duhet të posedoj ateste të çertifikuara me shenjën CE | $m^2$ | 1,850.00 | 15.25 | **18.00** | **18.00** | 28,220.34 | 5,079.66 | **33,300.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Furnizimi dhe montimi I kubzave te granitit (KALLDERMA VENDORE) me dimensione jouniforme te perpunuara ~ 10x10 x10cm me perdorim Brenda hapesires se sheshit per detale te veqanta si ne projekt. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres . Produkti është pjesë e sheshit ekzistues dhe merret nga vendi ku është deponuar nga kjo zonë.Te gjitha detalet ne pajtim me projektin dhe zgjidhje alternative sipas kërkesave te vetë investitorit dhe në pajtim me elementet e trashëgimisë kulturore. | $m^2$ | 525.00 | 5.08 | **18.00** | **6.00** | 2,669.49 | 480.51 | **3,150.00** |
| 3 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e rigolave në pjesën e sheshit prej materjalit natural me dimenzione30x30x10. Montimi I rigolave te behet ngjashem si pllakat | m' | 75.00 | 4.24 | **18.00** | **5.00** | 317.80 | 57.20 | **375.00** |
| | **TOTALI D :** | | | | | | **31,207.63** | **5,617.37** | **36,825.00** |
| ***E*** | ***PUNIMET MIKROURBANE*** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëse (me mbështetëse dhe pa mbështetëse ku vendoset. Materjali prej listellave të drurit të vendosura mbi muret e punuara nga betoni i armuarë i kombinuar me ulëse . Listellat e ulëses shtrihen mbi murit prej betoni (të papërshkrueshëm nga uji) me gjatësi l = 200 cm, me dimensione të listellës 5x10x55cm.i punuarë ne konstuksionin e hekurit Montimi i listellave bëhet në vend (sipas të detajit të dhënë). Të gjitha punët duhet të përfundohen në pajtim me projektantin dhe sipas udhëzimeve të dhëna nga organi mbikëqyrës. | cope | 10.00 | 67.80 | **18.00** | **80.00** | 677.97 | 122.03 | **800.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Furnizimi,transporti dhe instalimi i shportave për mbeturina nga prodhuesi me origjinë nga EU (sipas detajit të dhënë).Shporta është e përbërë prej një strukturë të fortë të fletave metalike të trasha 6mm me dy dyer (njëra fikse dhe tjetra që hapet) dhe mbyllëse/bravë prej çeliku. Dera punohet shufra vertikale çeliku 8 mm.Shporta është e pajisur me një unazë/rreth çeliku të zinkuar për të mbajtur thesin plastik të mbeturinave, një shpuzore/ tavëll duhani e cila është në dispozicion sipas kërkesës.Të gjitha pjesët metalike janë të zinkuara (në përputhje me standardet relevante UNI) dhe lyera me mveshje prej pluhuri poliester. Të gjitha pajisje shtesë janë çelik inox. ShpoShporta ka dimensione 400x400mm H1050mm me fiksimin në tokë me bulona. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres. Produkti duhet te jete me origjinë nga vendet e EU. | cope | 10.00 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 508.47 | 91.53 | **600.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Furnizimi, transporti dhe vendosja/instalimi i pengesave prej guri natyror për pjesët ku ndalohet qasja me automjete (sipas detajit të dhënë). Pengesa CUBO, modeli SA (SA30, SA40, SA45, SA50) nga prodhuesi (sipas detajit të dhënë).Materiali është gur natyror - Sienito CVL Monchique, me shtresë përfundimtare të flakëruar.Metodat e përforcimit : me ngjitje për trotuar ose e fiksuar mekanikisht.Dimesionet:15x85x45 cm . Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres. Produkti duhet te jete me origjinë nga vendet e EU. | cope | 120.00 | 16.95 | **18.00** | **20.00** | 2,033.90 | 366.10 | **2,400.00** |
| | **TOTALI E :** | | | | | | **3,220.34** | **579.66** | **3,800.00** |
| | | | | | | | | | |
| ***F*** | ***PUNËT E DHEUT*** | | | | | | | | |
| 1 | Gërmimi i kanalit nga dheu i kat. IV - V me makinë. Me gjersi varësisht nga diametri i gypit dhe thellësia. | $m^3$ | 60.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 101.69 | 18.31 | **120.00** |
| 2 | Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktesi ±1cm. | $m^2$ | 60.00 | 2.54 | **18.00** | **3.00** | 152.54 | 27.46 | **180.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km. | $m^3$ | 24.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 40.68 | 7.32 | **48.00** |
| 4 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa | $m^3$ | 6.00 | 4.24 | **18.00** | **5.00** | 25.42 | 4.58 | **30.00** |
| 5 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 0-61.5 mm për mbushjën e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103% | $m^3$ | 24.00 | 9.32 | **18.00** | **11.00** | 223.73 | 40.27 | **264.00** |
| | **TOTALI F:** | | | | | | **544.07** | **97.93** | **642.00** |
| | | | | | | | | | |
| **G** | ***PUNËT MONTUESE*** | | | | | | | | |
| 1 | Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët kryesor PESN8 Ø 300 - 315 x 1,03 = | m' | 120.00 | 3.39 | **18.00** | **4.00** | 406.78 | 73.22 | **480.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 prej grilave deri të pusetat e kolektorit kryesor. PESN8 Ø 200 mm 200 x 1,03 = | m' | 144.00 | 3.39 | **18.00** | **4.00** | 488.14 | 87.86 | **576.00** |
| | **TOTALI G:** | | | | | | **894.92** | **161.08** | **1,056.00** |
| | | | | | | | | | |
| ***H*** | ***PUNËT E BETONIT DHE PUNËT METALIKE*** | | | | | | | | |
| 1 | Furnizimi, transporti dhe betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 d=20cm | $m^3$ | 0.90 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 53.39 | 9.61 | **63.00** |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe betonimit për kineta më përpunim sipas detalit. | $m^3$ | 0.66 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 39.15 | 7.05 | **46.20** |
| 3 | Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø600/600mm (elemente të parafabrikuara). | copë | 10.00 | 29.66 | **18.00** | **35.00** | 296.61 | 53.39 | **350.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Furnizimi punimi dhe montimi I profilit nga materjali llamarin e plastifikuarë me trashësi t=0,7mmdhe gjëris të zhvilluarë b=1,75m'Vrejteje forma ekanlit duhet te jëtë sipas udhzimeve të org. mbikqyrës përfshirë edhe udhzimet e vndosjes në kanal. | m | 174.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 294.92 | 53.08 | **348.00** |
| 5 | Punet e kyqjes ne kanalin e ri te ujerave atmosferike prej rrugeve terthore. | paushall | 1.00 | 169.49 | **18.00** | **200.00** | 169.49 | 30.51 | **200.00** |
| | **TOTALI H:** | | | | | | **853.56** | **153.64** | **1,007.20** |
| | | | | | | | | | |
| *I* | ***NDRIÇIMI PUBLIK*** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi , Transporti dhe montimi i trupave ndriques te Tipit LEGEND GT 150Ë 230V HST/HIT-CE. Farar klasik me performancë të lartë optike per rrug, ideale për zonat urbane historike. • shpërndarja precize dritë siguron dritë jo te drejtpërdrejtë dhe te njetrajtshme. ka kapak dekorativ ne pjesen e siperme. pjesa e mbrenshme optike mund të rrotullohet deri në 45 ° shkalle për të ofruar shpërndarje të ndryshme te drites. trupi eshte prej aluminit te derdhur me ngjyr hiri te glavanizuar (e perafert me RAL 7043). Mbyllja eshte prej gjamit te fort, Reflectori eshte prej aluminit te anodizuar. Përmasat: 445 x 445 x 1000 mm.Pesha:<br>Ne qmim duhet parapare edhe shtyllat me lartesi prej 3.2 m i cila vjen me prodhuesin e trupit ndriques. Te gjitha sipas udhezimeve te projektantit. | copë | 18.00 | 52.54 | **18.00** | **62.00** | 945.76 | 170.24 | **1,116.00** |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit te zinkuar FeZn 25 x 4 mm | m' | 245.00 | 1.02 | **18.00** | **1.20** | 249.15 | 44.85 | **294.00** |
| 3 | Furnizimi, transporti dhe montimi i daljes per ndriqim te jashtem sipas skemes me te gjitha pjeset tjera percjellse. | copë | 4.00 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 169.49 | 30.51 | **200.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Porosia , furnizimi dhe montimi i kabllove furnizuese të tipit PPOO 4x16mm2, 1kV, per furnizim te llampave ndriquese. | m' | 230.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 389.83 | 70.17 | **460.00** |
| 5 | Furnizimi, transporti dhe montimi i kabllos furnizuese të tipit PP OO 3x1.5mm2, 1kV, nga kutia shperndarese e shtylles e deri te llampa ndriquese | m' | 615.00 | 0.76 | **18.00** | **0.90** | 469.07 | 84.43 | **553.50** |
| 6 | Furnizimi, transportii dhe montimi i shiritit per vrejtje nga PVC me gjersi 300mm. | m' | 240.00 | 0.17 | **18.00** | **0.20** | 40.68 | 7.32 | **48.00** |
| 7 | Furnizimi, transporti dhe montimi gypit te brinjezuar nga PVC Fi 70mm | m | 260.00 | 0.25 | **18.00** | **0.30** | 66.10 | 11.90 | **78.00** |
| 8 | Hapja dhe mbulimi i kanalit me dhe, me dimenzione ( 0.60 x 0,2 x 580)m, | m³ | 69.60 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 117.97 | 21.23 | **139.20** |
| 9 | Gërmimi I themeleve të shtyllave ndriquese me dimenzione ( 0.8 x 0,8 x 1,0)m | m³ | 11.52 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 19.53 | 3.51 | **23.04** |
| 10 | Betonimi dhe ankerimi I themeleve të shtyllave ndriquese me dimenzione ( 0,8 x 0,8 x1,0)m. Betonimi te behet me betonin e tipit MB-20. | m³ | 12.00 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 711.86 | 128.14 | **840.00** |
| 11 | Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e rërës së imët përgjat kanalit të kabllove me dimenzione (0,3 x 0,4 x 1840)m | m³ | 1.80 | 16.95 | **18.00** | **20.00** | 30.51 | 5.49 | **36.00** |
| 12 | Punimi i dokumentacionit teknik sipas gjendjes faktike | paushall | 1.00 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 13 | Matja dhe shqyrtimi i kabllove dhe stabilimenteve elektrike | paushall | 1.00 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 42.37 | 7.63 | **50.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Matja dhe atestimi i certifikuar i tokezimit mbrojtes te kuadrave shpërndarese elektrike furnizuese dhe per qdo shtyll ndriquse veq e veq. | paushall | 1.00 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 15 | Shqyrtimi dhe leshuarja ne pune e ndriqimit te jashtem. | paushall | 1.00 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 16 | Furnizimi , Transporti dhe montimi i reflektorve te Tipit me ngjyra LEGEND GT 150Ë 230V HST/HIT-CE | copë | 25.00 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 1,271.19 | 228.81 | **1,500.00** |
| 17 | Furnizimi me materjal , punimi dhe montimi I konstruksionit nga metali I derdhure për parkingun e 22 bisikletave I punuarë në kordinim org mbikqyrës dhe standardit për këtë llojë pune. | copë | 1.00 | 59.32 | **18.00** | **70.00** | 59.32 | 10.68 | **70.00** |
| 18 | Gërmimi I kanlit për vendojen e kabllit elektrik ne thellesi h=0,40m | m' | 248.00 | 1.27 | **18.00** | **1.50** | 315.25 | 56.75 | **372.00** |
| 19 | Furnizimi dhe montimi I kabllit per furnizimi eletrik 3x2,5 mm perfshire edhe gypin mbrojtës 63mm me dhe shirit parlemrues , në këtë pozcionë është I perfshirë edhe kyqja në rrjetin kryesore të brendshem | m' | 248.00 | 0.76 | **18.00** | **0.90** | 189.15 | 34.05 | **223.20** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | Furnizimi dhe montimi I trupave ndriques në pozitë horizontale led të tipit CN313 dhe kanlit mbrojtës nga materjali I rostfljë Imbrojturë nga korozioni dhe ndikimet e jashteme me dimensione 1,8x2,2x100cm me xham të qëndushëm ndaj ferkimevedhe pëshave të cilët do të vendosen në menyrë paralele me kyqje me gjeka qëdo 18m' .Vrejtëje instlimi i trupave ndiques dhe kanlit të instalohen sipas normave teknik dhe udhzimeve të org. mbikqyrës | m' | 513.00 | 21.19 | **18.00** | **25.00** | 10,868.64 | 1,956.36 | **12,825.00** |
| | Furnizimi dhe montimi I rrjetit | | | | | | | | |
| 21 | Punët e paparashikuara | paushall | 1.00 | 0.85 | **18.00** | **1.00** | 0.85 | 0.15 | **1.00** |
| | **TOTALI I:** | | | | | | **16,083.85** | **2,895.09** | **18,978.94** |
| | | | | | | | | | |
| ***J*** | ***PUNËT E GJELBRIMIT*** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-**Panja(Acer platanoides "Globosum")**, me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm,sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres. | copë | 35.00 | 0.85 | **18.00** | **1.00** | 29.66 | 5.34 | **35.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e dheut natyral-Tekstura e dheut duhet të jetë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, pra nuk duhet të jetë shumë e rëndë (argjilore) ose ranore. Nuk duhet të përmbaj gurë dhe mbetje tjera të padëshiruara. Pastaj duhet të jetë e pasur me materie ushqyese dhe të ketë pH optimale, përkatësisht mund të jetë e dobët acidike deri e dobët bazike. *Verejtje: Për këtë duhet pasur kujdes vendi se ku merret dheu, ai duhet të merret në shtresën e sipërme të tokës përkatësisht në thellësi 20-25 cm, e kurrsesi nuk duhet marr dhe në thellësi më të mëdha se 50 cm për shkak se kalon në substratin amë te tokës dhe nuk ka veti të mira fizike, kimike e biologjike.Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.* | $m^3$ | 120.00 | 4.24 | **18.00** | **5.00** | 508.47 | 91.53 | **600.00** |
| | **TOTALI J:** | | | | | | **538.14** | **96.86** | **635.00** |

# R E K A P I T U L I M I

| Nr. | Përshkrimi | Vlera me TVSH<br>në € |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| A | PUNËT E PËRGADITJES SË PUNISHTES | 5,531.20 |
| B | DEMOLIMI I INSTALIMEVE NË SHESH | 6,047.50 |
| C | PUNËT NDËRTIMORE | 19,141.33 |
| D | PUNËT E MVESHJEVE FINALE | 36,825.00 |
| E | PUNIMET MIKROURBANE | 3,800.00 |
| F | PUNËT E DHEUT | 642.00 |
| G | PUNËT MONTUESE | 1,056.00 |

| | | |
|---|---|---|
| H | PUNËT E BETONIT DHE PUNËT METALIKE | 1,007.20 |
| I | NDRIÇIMI PUBLIK | 18,978.94 |
| J | PUNËT E GJELBRIMIT | 635.00 |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM = | **79,376.42** |
| | TVSH= | **14,287.75** |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH = A+B+C+D+E+F+G+H+I+J | **93,664.17** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | "Rexha" sh.p.k. & "Eko Group" sh.p.k. |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Samir Rexha |
| NËNSHKRIMI: | SRexha |
| DATA: | 10.07.2019 |
| VULA: | |